



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRIË**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, gusht 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë*, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Mjellma Dibra Morina udhëheqëse e ekipit si dhe Fanol Hodolli dhe Antigona Çitaku anëtar të ekipit*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Zukë Zuka*.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	7
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	9
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	27
Shtojca II: Letër e konfirmimit	29

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Në kontekstin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në pajtim me SNKSP dhe rregulloret në fuqi.

Nga aspekti i aplikimit të parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ekzistojnë fusha ku nevojiten përmirësime në mënyrë që të arrihet ngritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Përmirësimet dhe zbatimi i menaxhimit të mirëfilltë financiar është i nevojshëm në të gjitha strukturat.

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve për vitin 2018, rezulton se 6 nga 13 rekomandimet e dhëna, ende nuk janë adresuar. Krahas zbatimit relativisht të ulët të rekomandimeve, Ministria nuk ka raportuar lidhur me Progresin për zbatimin e rekomandimeve. Rrjedhimisht, Ministria nuk ka të instaluar një proces për menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Si rezultat i kësaj, dobësi të vazhdueshme po identifikohen vit pas viti, me theks në menaxhimin e shpenzimeve si dhe efikasitet të ulët në realizimin e investimeve kapitale.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2019 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Si theksim të çështjes dëshirojmë të përmendim kompensimin e pagave në vlerë prej 124,874€ për 25 zyrtarë pa vijueshmëri në punë.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PFV) së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të MTI për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Bazuar në vendimin e Qeverisë nr. 06/39 i dt. 22.07.2015, MTI ka të angazhuar 25 punonjës për të cilët nuk ka dëshmi se kanë vijuar punën. Shpenzimet për këta punonjës për vitin 2019 ishin 124,874€ dhe konsiderohen shpenzime të parregullta të buxhetit. Edhe përkundër faktit se ministria kishte bërë përpjekje për adresimin e kësaj çështje gjatë vitit, ajo nuk kishte qenë në gjendje të siguroj angazhimin e tyre në punë.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalesjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Falënderojmë menaxhmentin dhe stafin e ministrisë për bashkëpunimin korrekt dhe ndihmën e ofruar gjatë procesit të auditimit.

Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, Ministri rekomandohet që çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri dhe ta zgjidhë në periudhën e ardhshme.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse ministria zbaton kërkesat sa i përket masave të kontrollit, ato nuk ishin mjaftueshëm funksionale. Një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve ishin ende të pazbatuara. Kjo kishte bërë që dobësi të njëjta të përsëriten edhe më tej. Duhet kushtuar vëmendjen e duhur dokumentimit të kontrollit si dhe ngritjes së llogaridhënies në aspektin e menaxhimit të buxhetit.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	12,677,391	11,563,655	7,672,217	66%	7,095,224	4,925,977
Granti i Qeverisë - Buxheti	8,152,256	7,569,631	6,951,394	92%	7,046,220	4,925,977
Të hyrat nga AKP	1,500,000	968,889	493,375	51%	0	0
Klauzola e investimeve	1,955,492	1,955,492	59,700	3%	0	0
Financimet nga Huamarrjet	1,069,643	1,069,643	167,748	16%	49,004	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,113,736€. Ky zvogëlim është si rezultat i vendimeve të Qeverisë apo ndryshimet e reflektuara për plotësimin e kërkesave buxhetore. Megjithatë, buxheti në fund të vitit kishte rezultuar me një tepriçë buxhetore prej 3,891,438€.

Në vitin 2019, ministria ka shpenzuar 66.3% të buxhetit final ose 7,672,217€, me një zvogëlim prej 23% krahasuar me vitin 2018. Kjo ishte ndikuar kryesisht për shkak të ngecjeve në projektet e

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

planifikuara për t'u financuar me klauzolën e investimeve dhe huamarrjet. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	12,677,391	11,563,655	7,672,217	66%	7,095,224	4,925,977
Pagat dhe Mëditjet	1,725,365	1,664,350	1,663,711	100%	1,591,815	1,399,399
Mallrat dhe Shërbimet	2,437,254	2,444,754	2,059,588	84%	1,684,470	935,457
Shërbimet komunale	109,280	109,280	67,475	62%	49,493	65,166
Subvencionet dhe Transferet	2,050,000	2,020,000	1,313,803	65%	1,943,046	1,475,695
Investimet Kapitale	6,355,492	5,325,271	2,567,640	48%	1,826,400	1,050,260

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti për shumicën e kategorive ekonomike ishte reduktuar si rezultat i kursimeve buxhetore që kishte deklaruar ministria në fund të vitit.

Në kategorinë e investimeve kapitale MTI, kishte planifikuar të financonte 13 projekte kapitale në vitin 2019. Të gjitha këto ishin projekte të bartura nga 2018. Prej tyre ishin 6 projekte të cilat nuk kishin filluar fare. Ngecjet për projektet që kanë të bëjnë me ndërtimin e parqeve të biznesit ishin ndikuar nga mos definimi i pronave nga komunat përkatëse.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e planifikuara në vitin 2019 ishin 1,693,747€, ndërsa ishin realizuar 1,998,379€, apo me një tejkalim plani prej 18%. Ato kanë të bëjnë me regjistrimin e pengut, pronësisë industriale, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, licenca për importimin e naftës, licencat për importin e duhanit dhe të hyrat tjera ku përfshihen të hyrat nga qiraja dhe taksa të ndryshme.

Nga të hyrat e realizuara kemi testuar 48 mostra substanciale në vlerë prej 37,041€ dhe 11 mostra për pajtueshmëri.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat jo tatimore	1,693,747	1,693,747	1,998,379	118%	2,250,946	1,854,733
Totali	1,693,747	1,693,747	1,998,379	118%	2,250,946	1,854,733

Çështja B2 - Planifikim i dobët i të hyrave

Gjetja Planifikimi i të hyrave është bërë përmes planifikimit të brendshëm dhe është i paraparë me planin afatgjatë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021.

Planifikimi i të hyrave është bërë vetëm në planin afatgjatë KASH dhe nuk ka një planifikim vjetor të të hyrave sipas departamenteve, agjencive dhe sipas llojit të të hyrave. Bazuar në realizimin e planit për vitin 2019 i cili ishte 118%, si dhe rekomandimit të dhënë për auditimin e vitit 2018, edhe këtë vit MTI kishte një planifikim të dobët të hyrave, i cili nuk ishte bazuar në plane vjetore të aprovuara të bazuara në një analizë të përgjithshme sipas llojeve të të hyrave.

Ministria planifikimin e bën sipas departamenteve që realizojnë të hyra dhe nuk zbaton një analizë të bazuar në një plan paraprak.

Ndikimi Planifikimi i të hyrave që nuk bazohet në analiza të mirëfillta të pasuara nga një plan vjetor i miratuar, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, ndikon në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit, me efekt edhe në procesin përfundimtar të shpenzimeve.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshi edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 1,664,350 nga të cilat janë realizuar 1,663,711€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 258 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 247. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 24 të rinj. Ne kemi testuar 40 mostra për teste substanciale në vlerë 25,070€, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja e identifikuar për mos vijueshmërinë në punë të stafit, është trajtuar tek pjesa e opinionit si Theksim i çështjes në kapitullin 1 të këtij raporti.

Çështja C1 - Mos kompensim i shtesave për profesionet deficitare

Gjetja Ministria paguan shtesat për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, e përcaktuar kjo me vendimin e Qeverisë nr. 02/39 i datës 08.10.2008.

Udhëheqësi i divizionit për TI dhe shërbime logjistike në departamentin për financa dhe shërbime të përgjithshme në MTI nuk përfiton shtesë si personel deficitar.

Sipas ministrisë, kjo gjendje është për shkak të refuzimit të ndryshimit të koeficientëve nga ana Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave me arsyetimin se ligji i pagave është në proces dhe duhet nivelizim i titujve të punës.

Ndikimi Mos pagesa e shtesave sipas vendimit të Qeverisë mund të bëjë që ministria të paditet nga personat e dëmtuar dhe kjo do t'i dëmtonte edhe buxhetin e ministrisë për pjesën e shpenzimeve administrative dhe do të zvogëlonte motivin e punonjësve për punë.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të vlerësoj situatën rreth kompensimit për profesionet deficitare duke siguruar se po zbatohen vendimet e qeverisë për të siguruar se personeli paguhet sipas dispozitave dhe akteve që lidhen me pozitat që mbajnë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 2,554,034€, prej tyre ishin shpenzuar 2,127,063€. Shpenzimet për këtë kategori kanë të bëjnë me: Shërbime kontraktuese tjera, shpenzimeve që lidhen me udhëtimet zyrtare, blerje për rezerva shtetërore, shpenzime të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, shpenzime të marketingut dhe publikimeve, dreka zyrtare dhe shpenzime tjera operative. Në këtë fushë kemi testuar 49 mostra për teste substanciale në vlerë 221,572€, dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Mbulimi i pozitave të përhershme me kontrata për shërbime të veçanta më gjatë se gjashtë muaj

Gjetja Sipas Ligjit për Shërbyes civil nr. 03/L-149, neni 12, organizatat buxhetore mund të angazhojnë punëtorë me afat të caktuar në bazë të kontratave "Marrëveshje për shërbime të veçanta", për më pak se gjashtë muaj.

Për vitin 2019 ministria ka vazhduar angazhimin me marrëveshje për shërbime të veçanta për më shumë se gjashtë muaj. Krahasuar me vitet paraprake ky numër është rritur, dhe në vitin 2019 ishin raportuar 68 të punësuar, krahasuar me 52 sa ishin në vitin 2018. Duke pasur parasysh periudhën e angazhimit, 45 prej tyre ishin të angazhuar për më shumë se gjashtë muaj. Për më tepër, në tre nga katër raste të testuara është vërejtur se nuk ka raport pune si dëshmi të pagesës për angazhimin në punë.

Duke pas parasysh që ministria mbulon edhe pozita të rregullta me këtë formë të angazhimit, mund të thuhet se kjo përdoret si program i rregullt i punësimit. Moskujdesi për të plotësuar pozitat e lira të aprovuara me buxhet, ka shkaktuar vazhdimin e këtyre kontratave.

Ndikimi Shfrytëzimi i kësaj forme të angazhimit të personelit kufizon konkurrencën dhe si pasojë mund të angazhohet personel me kompetencë të ulët që ka ndikim në cilësinë e shërbimeve si dhe mund të ndikoj që objektivat e përcaktuara të mos realizohen sipas programit vjetor të punës.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të siguroj që të plotësohen të gjitha vendet e lira të punës të aprovuara me buxhet dhe të siguroj se angazhimet e tilla iu përmbahen kërkesave ligjore.

Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin me avanset

Gjetja Sipas Rregullores nr. 01/2018 për përfundimin e viti fiskal, neni 7, mbyllja e avanseve për udhëtime zyrtare dhe parave të imëta duhet të bëhet deri me datën 15 janar të vitit të ardhshëm fiskal. Ndërsa, Udhëzimi 2004/07 për udhëtime zyrtare specifikon se arsyetimi i mjeteve të shpenzuara bëhet me fatura. Kufiri i shpenzimeve të lejuara për mëditje kalkulohet varësisht nga shpenzimet e mbuluara nga pala pritëse.

Nga testimi i 5 mostrave rezulton se nuk ishte respektuar afati i lejuar për mbylljen e tyre. Avanset ishin mbyllur prej 9 deri 24 ditë vonesë pas afatit të lejuar. Ndërsa nga 20 avanset e testuara janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në tre (3) raste (avanse për udhëtime në Francë akomodimi 450€, Shqipëri akomodimi 255€ dhe akomodimi 273€) në dëshmitë për pagesë mungonte fatura e akomodimit apo bashkëngjitur ishin dokumente të cilat nuk përmbajnë elementet e faturës;
- Në tre (3) raste, avanset e kalkuluara për mëditje: në Gjermani 252€, Shqipëri 156€ dhe Londër 364€, pagesat për mëditje janë kompensuar 100%, edhe pse nga dëshmitë shihet se një pjesë e shpenzimeve të ushqimit ishin të mbuluara nga pala pritëse;

- Në tre (3) raste të udhëtimeve, avansi për akomodim ishte paguar më tepër sesa lejohet me rregullore: për Gjermani 144€, Francë 524€, dhe Slloveni 138€ (e cila sipas ministrisë është ndikuar nga ri programimi i udhëtimit). Për këto pagesa nuk ishte dokumentuar aprovimi nga ZKA/mbikëqyrësi; dhe
- Veç kësaj, në PVF për 2019 shtatë³ avanse janë të pambyllura dhe të pa arsyetuara. Një rekomandim lidhur me këto ishte dhënë edhe në vitin 2018, ndërkohë që ministria ka deklaruar se kanë hasur në vështirësi në mbylljen e tyre, përderisa ka raste kur janë ndjekur edhe procedurat gjyqësore për kthimin e këtyre mjeteve.

Nga zyrtarët kyç lidhur me autorizimin dhe aprovimin e pagesave, nuk kishte arsye të qarta lidhur me këto çështje. Përderisa mbylljes së avanseve nuk i ishte dhënë prioriteti i duhur karshi pagesave tjera si dhe nuk ka pasur përpjekje efektive lidhur me mbylljen e tyre. Duhet theksuar se ministria ka mbuluar pozitën e Zyrtarit Çertifikues me zyrtar alternativ për më shumë se një vit i cili krahas detyrave të tij, kishte edhe një detyrë të rregullt brenda ministrisë.

Ndikimi

Mos arsyetimi i mjeteve me faturë si dhe mos respektimi i kërkesave dhe limiteve të përcaktuara me rregullat përkatëse, rrit rrezikun e keqpërdorimit me parane publike. Ndërsa mos efikasiteti i kontroleve me rastin e mbylljes së avanseve, rrit rrezikun e moskthimit të mjeteve dhe shfrytëzimin e pa autorizuar të tyre.

Rekomandimi C2 Ministri duhet të sigurohet se kërkesat rregullative janë mjaftueshëm të njohura tek zyrtarët e deleguar si mbajtës të buxhetit, duke ndikuar në ngritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve të cilët përfshihen në këto lloj shpenzimesh për të mos lejuar keqpërdorimet e mundshme të mjeteve të dhëna avans. Një rivlerësim i këtyre pagesave duhet të bëhet, dhe paratë e paguara tepër t'i kthehen buxhetit.

Çështja A1 - Mungesë e dëshmive për kërkesat dhe aprovimin e njërive të paguara

Gjetja

Sipas Udhëzuesit për Prokurim Publik neni 5 dhe UA 06/2018 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik nenet 3, 4 dhe 6 para çdo prokurimi të centralizuar kërkohet nga OB të vlerësojnë nevojat dhe paraqesin kërkesat të cilat presin aprovimin para inicimit të procedurës. Kontrata lidhet për njësitë e aprovuara sipas OB-ve.

³ Tre për parane e imët në vlerë prej 2,000€ i cili i takon vitit 2018, 1500€ i cili i takon vitit 2016, dhe 1000€ nga viti 2019, dy avanse për udhëtime zyrtare me vlerë 550€ dhe 150€ për të cilat ishte dokumentuar se kishte filluar ndalja e mjeteve në 2020, si dhe dy kredit kartela me vlerë 1,925€ dhe 307€.

Gjatë ekzaminimit të pagesës së qirasë për veturat sipas kontratës për 'Qiramarrje afatgjatë të veturave' nuk kemi hasur një dokument të kërkesave të aprovuara dhe pranuar për veturat me qira. Komunikimet në mes AQP dhe MTI ishin zhvilluar vetëm nëpërmjet postës elektronike. Rrjedhimisht, nuk mund të konfirmohet përdorimi i automjeteve dhe nëse pagesat e faturave në vlerë totale 5,446€ janë në pajtim me kushtet kontraktuese.

Nga ana e ministrisë, nuk kishte sqarime të bazuara dhe orientuese lidhur me kërkesën dhe numrin e veturave të aprovuara.

Ndikimi Mos respektimi i kërkesave rregullative lidhur me nevojën e përdorimit të veturave me qira, rrit rrezikun e keqpërdorimeve me paranë publike.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurohet se për procedurat e ndjekura janë lënë dëshmitë e zbatimit të kontrollit, si dhe në raste të tilla është bërë një vlerësim i drejtë i nevojave të ministrisë i dokumentuar dhe transparent.

Çështja A2 - Mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit

Gjetja Duke iu referuar Ligjit për Prokurim Publik neni 10, Zyrtari i Prokurimit (ZP) do të mban dokumentacionin origjinal për prokurimin përkatës i cili do të vihet në dispozicion sa herë kjo kërkohet nga organet mbikëqyrëse.

Pjesë e ekzaminimeve tona ishin katër procedura të prokurimit në lidhje me kategorinë e Mallra dhe Shërbimeve.

- Për dy procedura të zhvilluara, nuk kemi gjetur dokumentacionin origjinal tek zyrtari i prokurimit "Blerja e një dhurate - orë" dhe "Furnizim me veshmbathje". Nga zyrtari i prokurimit janë ofruar vetëm një pjesë e dokumentacionit në kopje; dhe
- Në kontratën lidhur për 'Mirëmbajtjen e Parkut të Biznesi Drenas' ishin përfshirë dy afate të ndryshme të zbatimit të kontratës. Sipas nenit 2 të kontratës afati kohor për kryerjen e shërbimeve ishte 24 muaj, kurse sipas Kushteve të veçanta të kontratës neni 6.4, koha e përfundimit të shërbimeve ishte 12 muaj, ndërsa inicimi dhe procedurat ishin zhvilluar duke theksuar afatin për 24 muaj.

Raste e tilla sipas ministrisë ishin vlerësuar si gabim teknike.

Ndikimi Mungesa e dokumentacionit origjinal për nevoja rishikimi, kufizon mundësinë e dokumentimit dhe krijon paqartësi nëse furnizimet dhe pagesat janë kryer sipas rregulloreve. Ndërsa, afatet kontraktore të kohëzgjatjes në shërbimet e mirëmbajtjes, mund të krijoj paqartësi në mes palëve kontraktuese dhe mund të përfundoj me konteste gjyqësore.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj se do të rishikohen kontrollet si në mbajtjen e dosjeve duke ofruar siguri në mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave, si dhe të përcaktoj në mënyrë të qartë dhe pa gabime afatet e kohëzgjatjes së kontratave.

Çështja A3 - Dreka zyrtare përmes modulit të blerjeve

Gjetja Sipas Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 me plotësim ndryshime, lidhja e kontratave për furnizim me mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale, duhet të realizohen përmes procedurave të prokurimit publik, me përjashtim të kontratave të cekura në nenin 3 të këtij ligji.

Dy pagesa për dreka zyrtare në vlerë prej 9,200€ dhe 6,767€ ishin procesuar përmes modulit të blerjeve edhe pse këto shërbime janë të përjashtuara nga procedurat e prokurimit. Pagesat ishin realizuar pa dëshmi të nevojshme lidhur me aktivitetin, si agjenda, lista e pjesëmarrësve dhe dëshmi të tjera të cilat arsyetojnë mjetet e shpenzuara. Ndërkohë që, edhe pse këto shpenzime janë të përjashtuara nga prokurimi publik, ato janë procesuar përmes modulit të blerjeve (përmes prokurimit).

Për më tepër, njëra nga pagesat edhe pse përmbante pjesën më të madhe të shpenzimit për nevoja të akomodimit, ishte kategorizuar si drekë zyrtare.

Zyrtarët përgjegjës për procesimin e pagesave të tilla nuk kanë ofruar ndonjë përgjigje të bazuar. Kjo është një praktikë e cila është ndjekur nga ministria për shpenzime të tilla.

Ndikimi Procesimi i këtyre shërbimeve nga zyrtarët e pa autorizuar është një indikacion lidhur me dobësitë e sistemit të kontrollit. Procesimi i pagesave pa u arsyetuar me dëshmi të mjaftueshme, rrit rrezikun e shpenzimeve të paarsyeshme dhe jo sipas çmimeve të tregut.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurohet se bëhen dakordimet e duhura para pranimit të çfarëdo shërbimi, si dhe të njëjtat dokumentohen me dëshmi të arsyeshme rreth shërbimeve të pranuar.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 2,020,000€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 1,313,803€. Ato kanë të bëjnë me subvencione për entitete jopublike të cilat përfshijnë ndarjen e

granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pagesat për pjesëmarrje dhe ndarje të hapësirave për panairët ndërkombëtare për promovim eksporti. Ne kemi testuar 24 mostra për teste substanciale në vlerë 652,115€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë, dhe nuk kemi identifikuar parregullsi.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,325,271€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 2,567,640€. Ato kanë të bëjnë me realizimin e projekteve kapitale, si: ndërtimi i zonave ekonomike, ndërtimi i parkut të biznesit në zonën ekonomike të Vushtrrisë, ndërtimi i parkut industrial në Qylagë – Lipjan, zhvillimi i fushave të reja të metrologjisë, inkubatorët e biznesit dhe disa projekte tjera.

Rishikimi dhe analizimi i investimeve kapitale, tregon se, realizimi i buxhetit për këtë kategori këtë vit mbetet sfidë me të cilën do të përballet MTI. Në kategorinë e investimeve kapitale, kanë qenë të planifikuara 12 projekte kapitale, ndërsa gjatë vitit 2019 për pesë (5) projekte nuk ka kurrfarë shpenzimi të fondeve, por vetëm për shtatë (7) projekte kishte filluar edhe ekzekutimi i pagesave. Ne kemi testuar 19 mostra për teste substanciale në vlerë 2,444,531€, si dhe shtatë (7) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 -Vonesa në realizimin e punëve në hartimin e projekteve

Gjetja Në kontratat e nënshkruara ndërmjet MTI së dhe Operatorëve Ekonomik (OE) për hartimin e projektit kryesor për zonën ekonomike në Malishevë, përcaktohet afati kohor për hartimin e projektit prej 35 ditë kalendarike.

Ne kemi identifikuar ngecje në hartimin e projektit kryesor për zonën ekonomike në Malishevë ku kontrata është nënshkruar me datë 12.07.2019 dhe projekti që duhej të hartohet dhe përfundonte brenda 35 ditë kalendarike, ka përfunduar me datë 23.12.2019. Rrjedhimisht, pas këtij afati kishte vonesë rreth 128 ditë kalendarike në hartimin dhe kryerjen e projektit.

Sipas menaxherit të projektit, shkak i vonesave në realizimin e projektit ishin mungesa e pëlqimit nga KEK-u dhe rrjetit të gazit, për çka edhe kishte kërkuar shtyrjen e kohës së paraparë për hartimin e këtij projekti.

Ndikimi Vonesat në përfundimin e projekteve, ndikojnë që MTI të mos arrijë objektivat e përcaktuara. Në anën tjetër, kjo situatë mund të ndikojë që OE të ushtrojnë padi gjyqësore ndaj ministrisë për shkak të mos përgjegjësisë ndaj zbatimit të projekteve apo mos krijimit të kushteve me kohë për fillimin e punës nga OE.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të sigurojë që MTI duhet të krijoj të gjitha parakushtet ndaj OE që hartimi i projekteve dhe punët tjera të kontraktuara të kryhen sipas kushteve të kontratës.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 14,764,484€, pasurive jokapitale është 95,231€, si dhe e stoqeve 940€. NE kemi testuar 20 mostra për teste substanciale në vlerë 2,267,757€, si dhe tetë (8) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Dobësi në procesin e inventarizimit

Gjetja Rregullorja për menaxhimin e pasurisë jo financiare MF 02/2013, neni 19 respektivisht paragrafi 4.3, përcakton se është detyrë e komisionit të inventarizimit të bëjë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare.

Komisioni i inventarizimit nuk ka bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë. Ndërkohë që, ministria nuk ka asnjë rregullore për procedura të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.

Kjo, për shkak të mos kuptuarit të drejt të kërkesave të rregullores dhe mungesës së procedurës dhe udhëzimit të brendshëm lidhur me menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi Mungesa e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë jo financiare, pamundëson konfirmimin e ekzistencës reale të pasurisë dhe nuk mundëson prezantimin e gjendjes së plotë dhe të saktë të pasurisë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të qartësojë kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzim të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe të trajtojë stafin relevant, në mënyrë që kërkesat e rregulloreve për pasuritë të zbatohen me konsistencë.

2.3 Të arkëtueshmet

MTI në PFV-të e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 204,254€. Kjo vlerë përbëhet nga qiraja në parkun e biznesit në Drenas, ndërsa pjesa tjetër janë nga shërbimet metrologjike. Ne kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale dhe pesë (5) për qëllime të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Efikasitet i dobët në inkasimin e borxheve nga qiraja**Gjetja**

Ministria ka dy lloje të kontratave për dhënien e parcelave me qira në parkun e biznesit në Drenas varësisht nga periudha. Për kontratat para vitit 2013 neni 3 përcakton “kushtet e pagesës së qirasë” - Qiramarrësi është i obliguar që prej datës 1 deri më 5 të kryej pagesën e qirasë të muajit vijues. Në rast të vonesës së pagesës së qirasë, qiramarrësi do të ndëshkohet konform kamatave bankare të cilat janë në fuqi. Ndërsa për kontratat pas vitit 2013 neni 2 përcakton “kushtet e pagesës së qirasë” - Qiramarrësi është i obliguar t’i paguaj qiranë qiramarrësit çdo 6 muaj, më së largu deri më datën 15 të muajit vijues. Në rast të vonesës së pagesës së qirasë, qiramarrësi do të ndëshkohet të paguaj interesin 5% të shumës së pagesës së qirasë. Ndërsa, neni 24 i kontratës përcakton se “e drejta e shkëputjes së njëanshme të kontratës bëhet në veçanti me rastin e shkeljes së detyrimeve kontraktuese nga ana e qiramarrësit të parapara me ligjet në fuqi.

Llogaritë e arkëtueshme nga qiraja në parkun industrial të Drenasit janë 203,876€ nga të cilat 68% janë llogari që i takojnë viteve 2010 deri 2018. Ndërsa, nga pesë (5) mostrat e testuara kemi hasur se nuk është paguar qiraja për vitin 2019, përderisa në katër (4) mostra ka mos pagesë edhe nga vitet paraprake. Të gjitha rastet e testuara janë fatura të cilat kanë tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar me kontratë. MTI ka ndërmarrë masa për të mbledhë borxhet, duke i dërguar lëndët në avokaturën shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë dhe procedurë përmbartimore, por edhe pas kësaj shuma e këtyre llogarive vetëm sa është rritur. MTI nuk ka ndërmarrë masa të shkëputjes së kontratës, siç kërkon neni 24 edhe pse qiramarrësit kanë shkëlur detyrimet kontraktuese, duke mos i paguar faturat për shfrytëzimin e parcelave të dhëna me qira.

Rritja e borxheve të pa mbledhura në mënyrë të vazhdueshme vjen si rezultat i përpjekjeve të vonuara dhe të pa mjaftueshme të viteve paraprake që operatorët të paguajnë qiratë për hapësirat që shfrytëzojnë në Parkun e Biznesit në Drenas.

Ndikimi

Rritja e llogarive të arkëtueshme në mënyrë të vazhdueshme rrezikon grumbullimin e mjeteve me kohë, vjetërsimin e tyre si dhe mundësinë që ato të mos inkasohen asnjëherë.

Rekomandimi B5

Ministri duhet të siguroj se do të shqyrtohen të gjithë mekanizmat ligjor në inkasimin e të arkëtueshmeve të vonuara, duke kalkuluar edhe interesin e përcaktuar nga tregu bankar dhe me kontratë. Në rastet e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga operatorët, të shqyrtoj mundësinë e shkëputjes së kontratave.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Sipas të dhënave në PFV, pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 245,451€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Çështja B6 - Menaxhimi i obligimeve

Gjetja Sipas nenit 39 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, organizata buxhetore duhet çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimin të faturës.

Detyrimet në vitin 2019 ishin dyfishuar krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2018 në PVF ishin raportuar 121,698€, ndërsa për 2019 obligimet ishin 245,451€ ku prej tyre 10,420€ ishin obligime të papaguara nga viti 2018, përderisa 16% e obligimeve të raportuara për vitin 2019 kishin kaluar afatin për pagesë prej 30 ditë. Arsye e mos pagesës ishte kryesisht mungesa e mjeteve.

Ministria nuk ka ofruar sqarime të mjaftueshme lidhur me rritjen e detyrimeve të pa paguara.

Ndikimi Rritja e detyrimeve në këtë mënyrë mund të ndikoj ekuilibrin buxhetor të ministrisë. Ministria mund të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi B6 Ministri i tregtisë duhet të siguroj se do të vendos nën kontroll detyrimet, duke siguruar fonde të planifikuara me buxhet, si dhe të kryej të gjitha detyrimet brenda afateve të përcaktuara ligjore.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2019, ishte 2,229,604€. Këto kanë të bëjnë me rastet ku MTI është në procedurë gjyqësore si e paditur dhe ende nuk ka një vendim final.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm është i themeluar me Statutin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB). NjAB operon me një anëtar dhe Drejtorin e Auditimit. Pozicionimi i NjAB në strukturën organizative i shërben misionit të saj të përcaktuar me statut. Plani i Auditimit të Brendshëm parasheh pesë (5) auditime të rregullta të përcaktuara sipas prioritetit të lartë katër (4) dhe të mesëm një (1). Gjatë vitit 2019 kanë arritur të realizohen të gjitha. Sa i përket fushëveprimit, të gjithë ishin përqendruar në aktivitetet e 2019.

MTI ka të themeluar Komitetin e Auditimit, mandati i të cilit përcaktohet me Statutin e Komitetit. Në funksion të realizimit të kërkesave ligjore, gjatë vitit kishte mbajtur gjithsej 6 takime.

Ne kemi ekzaminuar planin e zbatimit të rekomandimeve dhe sipas raporteve të AB gjatë vitit janë dhënë 14 rekomandime, dhe prej tyre, deri në kohën e zbatimit të auditimit ishin zbatuar 71%. NjAB ka hartuar raporte të rregullta periodike për aktivitetet e saj.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Ministria nuk ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, tre (3) rekomandime janë zbatuar; tre (3) ishin në proces, dy (2) të mbyllura të pazbatuara dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në vijim Tabelën e rekomandimeve.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PVF	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e parregullta për pagat e tyre. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, Ministri rekomandohet që çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.	Situatë e njejtë edhe në vitin 2019	Rekomandim i pazbatuar
2	PVF	Ministri duhet të rishikoj ne koordinim me Thesarin që ta rregulloje çështjen e regjistrimit dhe raportimit të të hyrave nga qiraja në SIMFK , të shqyrtohet mundësia nga aspekti teknik i sistemit që të hyrat të cilat i takojnë Komunës së Drenasit, të regjistrohen në kodin e sajë organizativ.	Ministria ka ndërmarrë hapat e saj pasi janë ndërmarrë veprime me iniciimin e procedurave për hartimin e një marrëveshje me komunën. Pjesa tjetër mbetet të ekzekutohet nga MF.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
3	PVF	Ministri duhet të siguroj se hartuesit e pasqyrave në bashkëpunim me departamentin ligjor do të jenë më të kujdesshëm gjatë shpalesjes së detyrimeve kontingjente duke prezantuar gjendjen e plotë të tyre në pasqyrat financiare.	Nuk janë hasur raste të tilla në analizën e PF dhe testimet e auditimit.	Rekomandim i zbatuar

4	Analiza e buxhetit	Ministri duhet të ndërtoj një bashkëpunim më të mirë me komunat dhe t'i eliminoj me kohë të gjitha problemet me shpronësimin në mënyrë që mos të ketë ngecje në inicimin dhe realizimin e projekteve lidhur me qendrat e bizneseve.		Rekomandim i mbyllur i pazbatuar
5	Të hyrat	Ministri duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshi edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprahe.	Testimet dhe analizat e zbatuara tregojnë situatë të njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar
6	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të rishikoj rastet e tilla dhe të siguroj se do të kompensohen punonjësit e dëmtuar sipas koeficientit të përcaktuar me akt emërim.	Bazuar ne rezultatet e testimit është pjesërisht e zbatuar pasi për shtesën e TI ende mbetet e pazbatuar adresuar çështja.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
7	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj që të plotësohen të gjitha vendet e lira të punës të aprovuara me buxhet dhe të siguroj se angazhimet e tilla iu përmbahen kërkesave ligjore.	Megjithëse janë ndërmarrë hapa lidhur me plotësimin e vendeve të punës, ende ka një numër në rritje të të punësuarve me MSHV për një periudhë mbi 6 muaj.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
8	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj menaxhim të mirë dhe të vendos kontrole adekuate lidhur me avancet duke i respektuar afatet ligjore për mbylljen e tyre, ndërsa mjetet e pa arsyetuara duhet të kthehen në buxhetin e ministrisë sipas kërkesave ligjore.	Nga dëshmitë dhe konfirmimet zyrtare kemi mundur të vërejmë se janë ndërmarrë veprime për mbledhjen e tyre pasi për disa nga to ka filluar ndalja e tyre ne 2020, por ka ende mbetet sfidë për ministrinë përderisa ka ende avance të pa arsyetuara nga periudhat paraprahe.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
9	Mallrat dhe shërbimet	Ministria duhet të siguroj se të gjithë menaxherët e kontratës, përgatitin dhe azhurnojnë planin për menaxhimin e kontratës, sipas kushteve të kontratës dhe realizimit të saj, në pajtim me ligjin në fuqi.	Testimet nuk kanë identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar

10	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri duhet të qartësoj kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzime të brendshëm lidhur me inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe të trajtoj stafin relevant, në mënyrë që kërkesat e rregulloreve për pasuritë të zbatohen me konsistencë.	Bazuar në rezultatet e testimit mbetet e pa adresuar.	Rekomandim i pazbatuar
11	Të arkëtueshmet	Ministri duhet të siguroj kompetencën tek zyrtarët përgjegjës në mënyrë që të mos prezanton si llogari të arkëtueshme urdhërpagesat e lëshuara klientëve.	Nuk janë hasur raste të tilla në analizën e PF dhe testimet e nevojshme.	Rekomandim i zbatuar
12	Të arkëtueshmet	Ministri duhet të siguroj se do të shqyrtohen të gjithë mekanizmat ligjor në inkasimin e të arkëtueshmëve të vonuara, duke kalkuluar edhe interesin e përcaktuar nga tregu bankar dhe me kontratë.	Mbetet një sfidë për ministrinë edhe më tej.	Rekomandim i pazbatuar
13	Obligimet e papaguara	Ministri i tregtisë duhet të siguroj se do të vendos nën kontroll obligimet duke mos hyrë në obligime pa fonde të planifikuara me buxhet, si dhe të kryej të gjitha obligimet brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Duke u bazuar në testimet e fushës ky rekomandim mbetet ende i pazbatuar. Obligimet janë në rritje, përderisa ka obligime të mbetura nga vitet paraprake ende pa u paguar.	Rekomandim i pazbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	PFV	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, Ministri rekomandohet që çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.		
2	Të Hyrat	Ministri duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshi edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake.		
3	Pagat dhe medijtjet	Ministri duhet të vlerësoj situatën rreth kompensimit për profesionet deficitare duke siguruar se po zbatohen vendimet e qeverisë për të siguruar se personeli paguhet sipas dispozitave dhe akteve që lidhen me pozitat që mbajnë.		
4	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj që të plotësohen të gjitha vendet e lira të punës të aprovuara me buxhet dhe të siguroj se angazhimet e tilla iu përmbahen kërkesave ligjore		
5	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të sigurohet se kërkesat rregullative janë mjaftueshëm të njohura tek zyrtarët e deleguar me mbajtjen e buxhetit duke ndikuar në ngritjen e		

		përgjegjësisë së zyrtarëve të cilën përfshihen në këto lloj shpenzime për të mos lejuar keqpërdorimet e mundshme të mjeteve të dhëna avanc. Të bëhet vlerësimi i dokumentacionit mbështetës dhe mjetet e paguara tepër të i kthehen buxhetit.
6	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të sigurohet se për procedurat e ndjekura janë lënë dëshmitë e zbatimit të kontrollit, si dhe në raste të tilla është bërë një vlerësim i drejtë i nevojave të ministrisë i dokumentuar dhe transparent.
7	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj se do të rishikohen kontrollet si në mbajtjen e dosjeve duke ofruar siguri në mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave, ashtu edhe në hartimin e dokumenteve kontraktuese.
8	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të sigurohet se po bëhen dakordimet e duhura para pranimit të çfarëdo shërbimi, si dhe që ato po dokumentohen me dëshmi të arsyeshme rreth shërbimeve të pranuar.
9	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që hartimi i projekteve dhe punët të kryhen sipas kushteve të kontratës, në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit.
10	Pasuritë kapitale dhe jokatitale	Ministri duhet të qartësoj kërkesat rregullative, të nxjerrë udhëzime të brendshme lidhur me inventarizimin e pasurisë jo financiare dhe të trajtoj stafin relevant, në mënyrë që kërkesat e rregulloreve për pasuritë të zbatohen me konsistencë.
11	Të arkëtueshmet	Ministri duhet të siguroj se do të shqyrtohen të gjithë mekanizmat ligjor në inkasimin e të arkëtueshmeve të vonuara, duke kalkuluar edhe interesin e përcaktuar nga tregu bankar dhe me kontratë. Në rastet e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga operatoret të shqyrtoj mundësinë e shkëputjes.
12	Detyrimet e papaguara	Ministri i tregtisë duhet të siguroj se do të vendos nën kontroll obligimet, duke siguruar mos hyrë në obligime pa fonde të planifikuara me buxhet, si dhe të kryej të gjitha obligimet detyrimet brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e konfirmimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Vesel Krasniqi

Ministër në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

Data: 30. korrik 2020,



Prishtinë